

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, dërguar me e-mail në lidhje me shërbimet elektronike që ka zhvilluar Bashkia Shkodër, ju infomojmë se të gjitha shërbimet administrative vendore që ofrohen nga insitucioni ynë janë elektronike që nga janari i vitit 2016.

Shërbimet administrative vendore elektronike ofrohen përmes Sistemit të Integruar të Zyrave me Një Ndalesë (SiZ1N), i cili është funksional dhe në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve në sportelet e Zyrave të Integruara me Një Ndalesë (Zi1N) në bashkinë Qendër, në 10 Njësitë Administrative dhe 5 Lagjet e bashkisë Shkodër.

Numri i shërbimeve administrative që ofrohen elektronikisht përmes SiZ1N është 69.

Më shumë detaje për mënyrën dhe rregullat e aplikimit si dhe kategoritë përfituese mund të shfletoni link-et e informacioneve të publikuara në faqen zyrtare të internetit të bashkisë Shkodër, si mëposhtë vijon:

[http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Mbi\\_sherbimet\\_qe\\_ofron\\_bashkia\\_1098\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Mbi_sherbimet_qe_ofron_bashkia_1098_1.php)

[http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Sherbimet\\_administrative\\_1195\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Sherbimet_administrative_1195_1.php)

Të gjitha shërbimet e ofruara përmes SiZ1N gjurmohen nga faqja zyrtare e internetit e bashkisë Shkodër përmes numrit të praktikës (numër unik identifikues) në link-un si mëposhtë vijon:

<http://ossh.ishkodra.net/PracticeHistory/TrackPractice/praktika.html>

Për sa i përket detyrimeve vendore vjetore në përputhje me dokumentin e Paketës Fiskale të vitit korrent, detyrimet për familjarët përllorariten në link-un:

<https://buxheti.info/shkoder/taxcalculator.aspx>

Ndërsa, detyrimet dhe faturat për bizneset përllorariten dhe shkarkohen në profilin elektronik me kredencialet përkatëse të secilit biznes në link-un:

<http://tax.ishkodra.net/Account/Login>

Për çdo paqartësi mbetemi në dispozicionin tuaj.

Duke ju falenderuar,

---

Bashkia Shkodër